



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 200, Datë 23.09.2020

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI KRITERET DHE PROCEDURAT
E NGRITJES NË DETYRË NË POZICIONIN E DREJTUESIT NË
PROKURORITË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM”**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 47, 52 dhe 174 të Ligjit Nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 184/ç dhe 189 të Ligjit Nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe nenin 41 të Ligjit Nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KRYETAR
GENT IBRAHIMI

